Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Gjatë kapitullit të ardhshëm, do t'a zgjerojmë idenë e rregullave për të kërkuar rregulla në faktorë, shumëfisha, thyesa, numra dhjetorë dhe numra negativë – numra që ju përdorni çdo ditë.

Do të filloni duke imagjinuar sikur punoni në një fabrikë që përdor makineri për të zgjatur gjëra të tilla si çamçakëz, tela dhe makarona spageti, aq herë sa ç'tregon numri i shkruar në makineri. Për shembull, në rast se dëshironi që një karamele e butë të shtriqet sa pesë herë gjatësia fillestare, mund të përdorni një makineri $\times 5$. Disa makineri mund t'i zëvendësoni me një varg makinerish lidhur së bashku, për të treguar *çiftet e faktorëve* për një numër. Për shembull, në vend të një makinerie $\times 10$, mund të përdorni një varg prej dy makinerish, nga të cilat e para është një makineri e tipit $\times 2$. A mund ta gjeni se cila do të jetë makineria tjetër?



Në thyesat dhe numrat dhjetorë ndeshen shumë rregulla numerike. Ja një rregull që përmbahet në thyesat që kanë të njëjtin emërues. Përpiquni të merrni me mend numrat në kolonën e fundit.

Thyesë	$\frac{1}{5}$	$\frac{2}{5}$	$\frac{3}{5}$	$\frac{4}{5}$	$\frac{5}{5}$	$\frac{6}{5}$	$\frac{7}{5}$	?
Numër dhjetor	0,2	0,4	0,6	0,8	1,0	1,2	1,4	?

Duke i njohur këto rregulla dhe njëkohësisht barasvlerat dhjetore të thyesave më të zakonshme, do t'a keni më të lehtë të kryeni llogaritje me thyesa dhe numra dhjetorë.

Fjalor Në këtë kapitull do të ndesheni me shumë terma të rinj për ju. Ja disa prej tyre:

vlerë absolute	**faktori më i madh i përbashkët**	**faktor**
numër i përbërë	**shumëfishi më i vogël i përbashkët**	**numër prim**
numër i përzier	**thyesa të barasvlershme**	**eksponent**
relativisht prim	**pjesë dhjetore e përsëritur**	**të kundërta**
shumëfish	**faktorizim prim**	

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Thyesa dhe numra dhjetorë ndeshen kudo. Kërkojini nxënësit të përshkruajë mënyrat e ndryshme se si përdoren thyesat dhe numrat dhjetorë në jetën e tij të përditshme (përveç parasë).